



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 102

Prishtinë, më 26.2.2014, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Haki Demolli, Mufera Shinik, Ardian Gjini, Arsim Bajrami, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi dhe Sreten Ivanoviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Behlul Zeka, Sefadin Kllokoqi – D4D, Albert Krasniqi-KIPRED, Myrna Macgregor – Ambasada e Britanisë së Madhe, Lejla Selimi, Zsolt Bartfai dhe Urim Salihu – OSBE, Shqipe Hetemi – Europa e re, Valmira Saraçi – KTV, Sylë Ahmeti – Kosova Sot, Valmir Klaiqi – Tribuna, Die Morina – Top Channel, Ramiz Lladrovci – deputet KMFP.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-192, për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-221, për Institutin e Kosovës për Administratë Publike;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-236, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-033, për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-232, për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës;

9. Njoftim me shkresën e Kryetarit të Komunës së Vushtrisë z. Bajram Mulaku;
10. Njoftim me shkresën e Sindikatës së shërbimit Civil të Kosovës, lidhur me grevën në Departamentin e Mjekësisë Ligjore;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari i Komisionit Arben Gashi, propozoi që pika tretë të hiqet nga rendi ditës.

Rendi ditës u miratua me propozimin e kryetarit të Komisionit, që pika e tretë të hiqet nga rendi ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës;

Arben Gashi, kryetar, paraqiti për diskutim versionin e Projektligjit me ndryshimet e dala nga mbledhjet e mbajtura më 14, 18 dhe 19 shkurt 2014. Ai shtoi se në tekstin e projektligjit janë inkorporuar edhe propozimet që i ka sjell KQZ-ja, kurse për diskutim paraqiti nenet 6.6, 11.9, 17.3, 31.3, 54.1 pika 0, 92.4, 103, 104.2 dhe 3, 108 dhe 117.6. Gashi kërkoi nga anëtarët që të deklarohen rreth këtyre dilemave që kanë mbetur para se Projektligji të procedohet për Kryesinë e Kuvendit.

Për dispozitat e theksuara nga kryetari Komisionit diskutuan: Albulena Haxhiu, Behar Selimi, Haki Demolli, Mufera Shinik Ardian Gjini, Arsim Bajrami, Armend Zemaj, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi dhe Sreten Ivanoviq. Diskutimet e plota janë dhënë në transkript.

Në momentin e votimin prezent ishin 10 deputetë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 6 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, nxori këtë:

Përfundim

Komisioni, duke vepruar në pajtim me nenin 55, të Rregullores së Kuvendit, Kryesisë së Kuvendit ia dërgon Projektligjin për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, për procedim të mëtejshëm.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-192 për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave;

Kryetari i Komisionit Arben Gashi, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-192, për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin ato.

Megjithatë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligjin nr. 04/L-192, për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike;

Arben Gashi, kryetar, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin nr. 04/L-221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin ato.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligjin 04/L-221, për Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-236 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;

Kryetari i Komisioni, Arben Gashi, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-236, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligjin 04/L-236, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-033, për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

Arben Gashi, kryetar, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-033, për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin ato.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-033, për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës;

Kryetari Arben Gashi, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin 04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin ato.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji 04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Njoftim me shkresën e kryetarit të Komunës së Vushtrrisë z. Bajram Mulaku;

Deputet u njoftuan me shkresën e kryetarit të Komunës së Vushtrrisë z. Bajram Mulaku, lidhur me problemet e pronave, për të cilat është zhvilluar edhe procedurë gjyqësore.

9. Njoftim me shkresën e Sindikatës së Shërbimit Civil të Kosovës, lidhur me grevën në Departamentin e Mjekësisë Ligjore;

Deputetet u njoftuan me shkresën e Sindikatës së Shërbimit Civil të Kosovës, lidhur me grevën në Departamentin e Mjekësisë Ligjore, për realizimin e shtesave në të ardhura.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetar i Komisionit
Arben Gashi
